

XHEVAT LLOSHI

**TË DHËNA DOKUMENTARE TË REJA MBI VEPRIMTARINË E
V. MEKSIT, G. GJIROKASTRITIT DHE K. KRISTOFORIDHIT***

Njohuritë që kemi pasur mbi veprimtarinë e tre përkthyesve të shekullit të kaluar: Vangjel Meksit, Grigor Gjirokastritit dhe Konstantin Kristoforidhit, mbështeteshin kryesisht në kujtimet e shkruara më vonë dhe në shqyrtimin e veprave të botuara, por shumë pak në të dhënat dokumentare. Për këtë arsye ka pasur vend për mendime të ndryshme mbi jetën e punën e tyre dhe shumë anë të qenësishme nuk ka qenë e mundur të ndriçoheshin qartë.

Dihej që botimet e përkthimeve ishin bërë nga Shoqëria biblike britanike dhe për vendet e huaja (British and Foreign Bible Society, shkurtimisht BFBS), prandaj në mesin e vitit 1972, sipas planit shkencor të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë për kërkimet arkivale dhe bibliografike, u bënë kërkime në arkivin e kësaj shoqërie në Londër. Gjate Luftës së dytë botërore, për fat të keq, dy të tretat e fondeve të arkivit janë dëmtuar, kështu që ka mungesa të ndjeshme. Në shekullin e kaluar ka pasur edhe një praktikë, e cila e ka çenuar vlerën e dokumentave: letrat origjinale nuk ruheshin, por kopjoheshin me kujdes në libra të veçantë dhe pjesërisht botoheshin. Me një kërkim tjetër më të imtë ka mundësi të gjenden edhe materiale të tjera, sidomos pas shqyrtimit të lëndës së sjellë, që na jep fijet për gjurmim me pikësnyim tashmë të përcaktuar. Me gjithë këto zbrastësi, dokumentat e sjellë na lejojnë të japim një trajtim të ri më të plotë të veprimtarisë së këtyre punëtorëve të shquar në lëmin e gjuhës shqipe gjatë asaj periudhe, në të cilën u përgatit hap pas hapi lëvizja e madhe kombëtare e Rilindjes.

I. Vangjel Meksi

Botimi në gjuhën shqipe i përkthimit të Dhjatës së re në vitin 1827 ka pasur një rëndësi të dyfishtë: duke përhapur përdorimin e shqipes së shkruar, ai nxiti interesin për leximin e gjuhës amtare dhe njëkohësisht u bë një burim i çmueshëm për studimin e shqipes¹. Pa

*) Në këtë numër po botojmë pjesën e parë të këtij punimi dhe dokumentat që lidhen drejtpërdrejt me të. Pjesa tjetër e punimit dhe dokumentat përkatës do të botohen në numrat e ardhshëm.

1) Shih: *Historia e letërsisë shqipe*, vëll. I, T. 1959, f. 324.

këtë vepër, ka shkruar J. Falmerajeri², Ksilanderi «nuk do të kishte mundur të bënte asgjë me tepër nga ajo që kishte bërë me sukses Liku». Ndërsa G. Majeri thotë: «Ishte një minierë e çmueshme për punimet gramatikore të Ksilanderit e të Hahnit»³. Vetë G. Majeri, ashtu si Ksilanderi, Kamarda dhe Hahni më parë, ka ribotuar pjesë të përkthimit.

Me gjithë pranimin njëzëri të vlerës së kësaj vepre, të cilën Dh. Kamarda e quan «monumentin më të shquar që kemi deri më sot për idiomën epirote»⁴, gjatë një shekulli e gjysmë autorësia e përkthimit ka mbetur një çështje e hapur. Pikëpamjet e studjuesve kanë qenë të ndryshme. Disa, si Ksilanderi, Falmerajeri e Majeri e kanë përdorur lëndën e tij pa u shprehur për autorin.

Pikëpamja e parë quan autor të përkthimit Grigor Gjirokastritin. Me sa duket, i këtij mendimi ka qenë J. Hahni, kur shkruante: «...përkthimi toskërisht që ka dalë më 1827 në Korfuz i Dhjatës së re prej Grigorit, kryepeshkopit nga Eubea».⁵ E gjejmë edhe më vonë këtë mendim⁶, por në mënyrë të prerë është shprehur nga E. Kurilla. Nën titullin e botimit të vitit 1827 gjenden fjalët «nën kujdesin e Grigorit, kryepeshkopit të Eubeas». Duke u mbështetur vetëm e vetëm tek fjala «nën kujdesin» (epistasia) në mënyrë tendencioze dhe aspak për të gjurmuar të vërtetën me qëllime shkencore, ky autor përpiqet me çdo kusht të tregojë se përkthimi është vepër vetëm e G. Gjirokastritit,⁷ kërkon të gjejë gjithashtu mbështetje në mendimet e P. Kupitorit⁸.

Pikëpamja e dytë, mjaft e përhapur, e quan përkthimin punë të disa vetëve njëkohësisht. I pari që e formulon atë është Dh. Kamarda: «Përkthimi i Dhjatës së re, ndonëse është bërë nën drejtimin dhe mbikqyrjen e kryepeshkopit të Eubeas, Grigorit, tregon se është bërë nga disa njerëz nga më të ngriturit e të arësimit prej krishterëve të Epirit.»⁹ T. Evangjelidhi pranon dy bashkëpunëtorë: «në përkthimin punoi së bashku me Grigorin edhe dhaskali i Serezit K. Meksi, Meksikanikoj prej Shqipërie»¹⁰. Po këtë pranon edhe A. Xhuvani: «Grigori jo vetëm që ka pasë drejtimin e shqyrtimin e punës, por edhe ka marrë

2) J. Ph. Falmerayer, *Das Albanesische Element in Griechenland*, I Abt. 1857, f. 433.

3) G. Meyer, *Della lingua e della letteratura albanese*, në «Nuova antologia», 15.IV.1885, f. 597.

4) D. Camarda, *Appendice al saggio di Grammatologia Comparata sulla lingua albanese*, Prato 1866, f. XII.

5) «Die Hauptquelle, aus welcher dieselbe schöpfte, ist die im Jahre 1827 in Korfu erschienene toskische Uebersetzung des neuen Testaments von Gregorius, Erzbischof von Euböa», J. G. von Hahn. *Albanesische Studien*, III Heft, 1854, f. V.

6) «Shqipëronjësi i të katër Ungjijvet, i Punëvet dhe i Kartëravet ngjan të ketë qenë edhe vetë Grigori». *Një qintvjetore që ka një rëndësi për neve*, në «Diturija, e përkohshme shqiptare», 1926, V. II, nr. 7, f. 250; «Një rëndësi të veçantë gjuhësore ka dhe përkthimi i Dhjatës së re prej Grigor Gjirokastritit», E. Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, T. 1936, f. 32.

7) E. Kurilla, *Studime shqiptare*, (greqisht) 1933, në veçanti f. 4.

8) Shih përkthimin në «Orë», 7.XI.1930, f. 4.

9) D. Camarda, *vep. cit.*, f. IV.

10) Në «Nea Ellas», 1913, f. 17, sipas I. M. Qafëzezit, *Theodor Nastas Kavalioti*, 1951, monografi e pabotuar, në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë.

pjesë aktive në këtë përkthim tue pasë duket ndonji shok»,¹¹ Arbëreshi G. Petrota siç duket, gjithashtu është për disa përkthyes: «Është fjala gjithmonë për një përkthim nga një gjuhë tjetër dhe përkthyesit janë përpjekur të ndiqnin ndërtimin e greqishtes biblike të tekstit origjinal»¹². Në ditët tona kjo pikëpamje është përkrahur nga autorët e «Historisë së letërsisë shqipe», aty flitet për një grup përkthyesish: «Shqipërimi u bë nga një grup shqiptarësh të emigruar në Korfuz; drejtues qe peshkopi Grigor Gjirokastriti e përkthyesi kryesor Vangjel Mexsi nga Labova»¹³.

Pikëpamja e tretë quan si përkthyes Vangjel Maksin. I pari që shprehet për këtë është J. Vretoja: «Edhe në gjuhën shqipe, me anë të labovinit Vangjel Mexsi, siç kam dëgjuar, ka përkthyer dhe shtypur Dhjatën e re në dialektin toskërisht»¹⁴. Duke kundërshtuar manipulimet e E. Kurillës dhe duke njohur mendimin e Vretos, e mbron këtë pikëpamje me këmbëngulje I. M. Qafëzezi: «del në shesh kthjellur se jo Mexsi të ketë qenë «bashkëpunonjës i Grigorit në përkthimin shqip të Dhjatës» sikundër thotë Kurilla (Gr. Gjirokastriti, f. 54, nota) po Grigori të ketë qenë me të vërtetë vetëm «epistat», përkujdestar e mbikqyrës i botimit, një korrektionjës tipografie i ditëve të sotme»¹⁵. E ka mbështetur këtë pikëpamje në mënyrë të vijueshme Dh. Shuteriqi¹⁶: «Vretua në Skepsis, f. 98-99 na mëson se përkthimin shqip të ungjijve botuar nga Grigor Gjirokastriti më 1827, e bëri Vangjel Mexsi Laboviti»¹⁷. Edhe «Historia e Shqipërisë» njeh për përkthyes V. Maksin, por nën mbikqyrjen e Gr. Gjirokastritit: «Më 1824 dhe 1827 në Korfuz u botuan përkthimet e para shqipe të testamentit të ri në dialektin jugor, të bëra nga mësuesi shqiptar Vangjel Mexsi nën mbikqyrjen e peshkopit Grigor Gjirokastriti»¹⁸.

Siç shihet, kanë bashkëjetuar mendime të ndryshme, për arsye se nuk ka pasur një argumentim bindës e përfundimtar për njërin prej tyre. Është interesante të përmendet, që edhe S. E. Man,¹⁹ për të cilin në Londër ishte e lehtë të merrte informata të sakta nga Shoqëria biblike, shprehet me hamëndje: «Grigori, peshkopi shqiptar i Eubeas, ka mbikqyrur botimin e një Dhjate të re në dy gjuhë, e cila

11) A. Xhuvani, *Grigor Gjirokastriti*, në «Shkrimtarë shqiptarë», I, T. 1941, f. 90.

12) G. Petrota, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo 1932, f. 75.

13) *Historia e letërsisë shqipe*, vëll. I, T. 1959, f. 249. Autorët e vëllimit I janë Dh. Shuteriqi, K. Bihiku, M. Domi, V. Bala, Z. Kodra, Z. Sako, porse kapitulli për përkthyesit e ungjillit është shkruar nga M. Domi. Në f. 323 gjithashtu lexojmë: «Peshkopi Grigori shihet të ketë qenë njeri i ditur. Po në përkthimin e Ungjillit kanë marrë pjesë edhe të tjerë. Më 1824 ishin grumbulluar në Korfuz shumë shqiptarë të krishterë, të ikur nga Shqipëria, në mes të cilëve mjaft burra të mësuar. Përkthyesi kryesor i Dhjatës së re duhet të ketë qenë Vangjel Mexsi nga Labova e Gjirokastrës».

14) J. Vreto, *Vepra të zgjedhura*, T. 1973, f. 266.

15) I. M. Qafëzezi, *rep. cit.*, f. 44.

16) «Botonjës ishte Grigor Gjirokastriti e përkthyes Vangjel Mexsi» Dh. S. Shuteriqi, *Historia e letërsisë shqipe*, Tiranë 1958, f. 20.

17) Dh. S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1322-1850*, T. 1965, f. 131.

18) *Historia e Shqipërisë*, v. II, T. 1965, f. 45. Autorët e vëllimit II janë A. Buda, K. Frashëri, S. Pollo, J. Alibali, N. Plasari, porse kapitulli XI është hartuar nga A. Buda.

19) S. E. Mann, *Albanian literature*, London 1955, f. 14.

thuhet se është vepër e Vangjel Meksit nga Gjirokastra dhe e një grupi ndihmësish, që banonin në pjesën jugore të ishullit». ²⁰

a. *Përkthimi i veprës.*

Në arkivin e Shoqërisë biblike në Londër ruhet kopja e marrëveshjes së bërë për përkthimin (dok. I), të cilën po e japim të plotë. ²⁰ Atë e kanë nënshkruar V. Meksi dhe Robert Pinkertoni. Ky i fundit ishte përfaqësues i Shoqërisë biblike në Moskë dhe në vitin 1816 është kthyer prej andej për punë të ndryshme të Shoqërisë. Në Vjenë ka takuar disa nga shqiptarët, të cilët kishin formuar një koloni të vogël atje. Në letrën e tij të datës 28 gusht 1816 (dok. II) ai parashtron nevojën e një përkthimi shqip. Nga njoftimet e përpikta të kësaj letre për gjuhën shqipe, për numrin dhe përhapjen gjeografike të shqiptarëve, për gjendjen e shërbimit fetar, për përhapjen e shkrimit ndërmjet shqiptarëve, ne mendojmë se mund të nxirret vetëm një përfundim: idenë për një përkthim edhe në shqipen ja kanë dhënë R. Pinkertonit këta shqiptarë. Të dhënat e kësaj letre janë argumentat që ata kanë paraqitur për nevojën e përkthimit dhe, po të bëjmë një paralelizëm, janë të njëjta me argumentat që do të japë më vonë K. Kristoforidhi përsëri për të bindur misionarët biblikë mbi nevojën e përkthimeve të veta. Përfaqësuesit biblikë e kishin të domosdoshme në praktikën e tyre që të mblidhnin informacion të plotë të kësaj natyre përpara se të ndërmerrenin diçka ose të pranonin një propozim. Bie në sy në mënyrë të veçantë në këtë letër trajtimi i çështjes së alfabetit: mendimin se alfabeti grek me disa shtesa do të jepte mirë tingujt e shqipes dhe se shqiptarët do ta lexonin menjëherë këtë alfabet, mund ta shprehte vetëm ai që e dinte shqipen dhe që kishte mësuar të lexonte e të shkruante greqishten si gjuhë të huaj.

Përpara se të vijë në Stamboll më 1819, R. Pinkertoni ka kaluar edhe në Korfuz. Në një letër të tij të datës 25 tetor 1819 thuhet: «Ndonëse në Korfuz filloi të hapej perspektiva dhe gjithë shpresat e realizimit po gjenin përshëndetje, përsëri nuk u bë asgjë vendimtare». Botimi më vonë pikërisht në Korfuz i përkthimit na del kështu jo i rastit. Atje kishte shqiptarë të pregatitur për të shkruar shqip. Ka të ngjarë që R. Pinkertoni u takua për herë të parë me V. Maksin në Stamboll në 1819 dhe puna filloi menjëherë. Në tetor ai tashmë kishte përkthyer kreun e pestë të Mateut dhe kreun e parë të Joanit, të cilat ja tregon Pinkertonit. Më 19 tetor është nënshkruar marrëveshja e rregullt midis tyre.

Në fillim të vitit 1821 në Stamboll vjen si përfaqësues i Shoqërisë biblike Henri Daniel Livz (Henry Daniel Leeves), i cili merr menjëherë në dorë punët e lëna nga Pinkertoni. Më 8 shkurt 1821 Livzi i shkruan Londrës se përkthimi ka mbaruar dhe çështja është për të gjetur

20) Do të japim në fund dokumentat më të rëndësishëm në përkthimin tonë nga anglishtja. Fotokopjet e tyre ruhen në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë. Për lehtësi do të shënohen gjatë punimit në kllapa me shifra romake. Gabimet dhe pasaktësitë nuk janë ndrequr gjatë përkthimit, me qëllim që të mos cënohen më tej.

një redaktor. Në këtë mënyrë, përkthimi i veprës nga V. Meksi ishte bërë plotësisht brenda 15-16 muajve.

Ka rëndësi të theksojmë se përkthimi është bërë i plotë, pasi në disa dokumenta të mëvonshme të dhënat na dalin kontradiktore prej vetë përfaqësuesve të BFBS. Besojmë se kjo është një nga arësyet që e ka ngatërruar më pas çështjen e autorësisë së përkthimit. Isak Laundzi (Isaak Lowndes), në fillim sekretar i Shoqërisë biblike joniane dhe më pas përfaqësues i BFBS për një periudhë shumë të gjatë, në një shënim që bën në fund të studimit të K. Kristoforidhit më 1860 (dok. VIII) e vë në dyshim që V. Meksi e ka përfunduar përkthimin dhe thotë se atë e bëri G. Gjirokastriti. Po ai më 12 dhjetor 1867 (dok. III) thotë se dorëshkrimet e V. Meksit nuk ishin të plota dhe ishin të parregullta. E vërteta mbetet që në shkurt 1821 V. Meksi e kishte përfunduar përkthimin. Këtë gjë e ka shkruar vetë Laundzi në atë kohë, kështu më 16 mars 1824 thotë: «Shuma që mori Meksi për gjithë Dhjatën e re na del se ka qenë 6000 piastra». (dok. V), me fjalë të tjera, sipas marrëveshjes V. Meksi ka marrë edhe të hollat me përfundimin e veprës. Në raportet e BFBS (vëllimi VII, raporti 28 viti 1822, f. 50) thuhet se ka mbetur puna të shqyrtohet dorëshkrimi, që ka mbaruar.

b. Përkthyesi.

Mbi jetën e përkthyesit njoftimet kanë qenë dhe mbeten të pakta. Më 1803 ai është dërguar nga Ali Pasha në Napoli për të studjuar mjekësinë, siç del nga letërkëmbimi i Ali Pashës.²¹ Është e qartë që ai ka mbaruar studimet në rregull dhe ka punuar si mjek, prandaj në marrëveshjen më 1819 përmendet si dr. Vangjel Meksi, kurse në faqen e parë të përkthimit të vet shkruan *ngaha jatro Vangjel Meksikoj*. Prej letrës së R. Pinkertonit (dok. II) dhe nga vetë marrëveshja del se më 1819 ai ka qenë në Stamboll. Në letrën e 25 tetorit Pinkertoni shton se atë ja kanë rekomanduar disa nga dinjitarët më të lartë të komunitetit fetar aty si një njeri me cilësi të shquara për punën e përkthimit. Me sa duket, për përkthimin Meksi ka punuar në Stamboll, sepse në letrën e Livzit të datës 8 shkurt 1821 thuhet: «Përkthimi ka përfunduar, por Meksi ka shkuar në Selanik, sapo të kthehet, siç i ka shkruar (Meksit) Hilarioni, duke i shprehur këtë dëshirë, ne duhet të bëjmë marrëveshjen me një rishikues».

Në «Historinë e letërsisë shqipe»²² thuhet se ai ka qenë mësues në shkollën greke të Serezit pas vitit 1830. Dokumentat nga disa drejtime na dëshmojnë se ai mund të ketë vdekur shpejt pas përfundimit të përkthimit. Në Raportet e BFBS (vëllimi VII, raporti i njëzetë, viti 1824, faqe XLVII) thuhet se një kopje e përkthimit është dërguar në Korfuz për rishikim, por përkthyesi ka vdekur. Edhe në letrën e 12 dhjetorit 1867 Laundzi (dok. III) e përsërit që përkthyesi vdiq para se sa ta përfundonte punën (ne e treguam që kjo e dyta nuk

21) G. M. Monti, *Ali di Tepeleni e Ferdinando I di Borbone*, «Rivista d'Albania», Anno II, fasc. I, 1941, f. 48-50.

22) *Vep. cit.*, f. 323.

është e saktë). H. Livzi në letrën e 24 majit 1832, kur viziton Gjirokastrën, flet për të në kohën e shkuar; «Pashë me kënaqësi se gjuha e përkthimit i përshtatej mjaft mirë kësaj krahine të Shqipërisë, që ka qenë vendlindja e përkthyesit dr. Meksit, emri i të cilit njihej mirë këtu dhe respektohej». Na mbetet të pranojmë që pak pas vitit 1823 Vangjel Meksi të ketë vdekur.²³ Emri i tij nuk ndeshet më vonë, në të gjithë punën për redaktimin e për botimin, nuk del në kopertinën e librit dhe as në ndonjë marrëdhënie tjetër, pasi duke qenë ai laik, botuesit kanë parapëlqyer emrin me autoritet të G. Gjirokastritit si peshkop.

c. Alfabeti dhe gjuha e përkthimit.

Në fillim të vitit 1822 dorëshkrimi i V. Meksit është dërguar në Maltë tek U. Xhavit (W. Jowett) për ta ruajtur deri sa të gjendeshin redaktorët e nevojshëm. Pasi Xhavit ka njoftuar Londrën për mbërritjen e dokumentit, më 12 korrik vendoset që ai të nxjerrë një kopje të plotë dhe të presë udhëzime. Në maj të vitit 1823 u dërgua një kopje e Mateut në Korfuz. Më 1824 është dërguar një kopje e plotë, e cila, siç shkruan I. Laundzi më 2 gusht 1824, ka qenë për disa kohë në ishullin Zante.

Në arkivin e BFBS në Londër ne gjetëm pikërisht këtë kopje të plotë²⁴. Është një fletore e trashë me 880 faqe dhe në faqen e parë ka në krye këtë mbishkrim: *Τε κηγεριτέ ε σειυτ Ματθέυτ εύαγγελιτιύτ υτέ γγιγχε σκιπε γκαχά ιατρο Βαγγέλ Μεξικόυ*. Megjithëse ky titull përmend vetëm Mateun, dorëshkrimi është i plotë, ashtu siç është botuar më 1827.

R. Pinkertoni më 1816 kishte kërkuar që përkthimi i ardhshëm të botohej me alfabetin grek (dok. II). Mirëpo alfabeti i greqishtes nuk mund të zbatohet me lehtësi për shqipen, për shkak të ndryshimeve në sistemin fonetik midis dy gjuhëve. Në këto rrethana V. Meksi i dilte në të vërtetë detyra të përpunonte një alfabet të shqipes. A ka ndjekur ai ndonjë traditë të mëparshme, apo ka krijuar vetë një alfabet origjinal? Përgjigja e saktë e kësaj pyetjeje mund të jepet po të bëhet një krahasim me dorëshkrimet e mëparshme, megjithatë ne mendojmë se ka më tepër të ngjarë që ky të jetë një alfabet origjinal. Nga një letërkëmbim që ka pasur I. Laundzi më 1824 me T. P. Platt (i Komitetit të BFBS në Londër) na dalin disa të dhëna. Me 2 gusht Laundzi shkruan: «Kur kam parë punën e dr. Meksit, një nga gjërat e para që më ra në sy ishte përse ai kishte futur ital. *b* kur mund të bënte punë greq. *μπ* dhe ital. *d*, kur *υδ* do të shkonte, ndërsa në vende të tjera kishte *μπ* dhe *υδ*?» V. Meksi i kishte përdorur këto shkronja për të dalluar *b* nga *mb* (si tek *birit* dhe *mbëretnë*), e gjithashtu *d* nga *nd*, por ajo që ka rëndësi është se Meksi ka përzjerë alfabetin e greqishtes me disa shkronja latine. Duke kuj-

23) I. M. Qafëzezi në monografinë e pabotuar (*vep. cit.*) gjithashtu ka shprehur dyshimin mos Meksi ka vdekur përpara botimit të plotë.

24) Dorëshkrimi është dërguar në Londër nga Stambolli në vitin 1927 dhe ruhej i paidentifikuar, pasi askush nuk ishte interesuar dhe alfabeti ishte i tillë, që arkiivistja K. J. Cann nuk kishte mundur ta përcaktonte.

tuar rrethanën biografike, që ai kishte studjuar në Itali, kjo përzjerje bëhet e qartë, por nga ana tjetër, ky është një argument, që kemi të bëjmë me një zgjidhje origjinale të alfabetit. Prania e këtyre shkronjave ka bërë që më 1867 (dok. III) Laundzi të shkruajë se Meksi kishte përdorur një alfabet latin. U tha edhe më lart, se në këtë letër të Laundzit ka mjaft pasaktësi, por sidoqoftë faktin që Meksi nuk kishte përdorur thjesht alfabetin grek Laundzi nuk e ka harruar edhe pas 40 vjetësh. Duke diskutuar me T. P. Platin më 1824 për shkronjën *h*, Laundzi ka vënë re se Meksi ka dalluar një *h* dhe një *h* të aspiruar. Meksi e ka bërë dallimin duke i vënë një ose dy pika sipër shkronjës greke χ për *h* të aspiruar por dorëshkrimi nuk është konsequent. Arësyeja është: «Këtë mungesë uniformiteti unë ja atribuoj faktit që dorëshkrimi nuk është me dorën e tij, por ndoshta është kopjuar nga një njeri, që nuk e kuptonte shqipen». (letra e dt. 2 gusht 1824). Këtë fakt e përmendim, sepse duhet mbajtur para sysh gjatë shqyrtimit të dorëshkrimit që gjendet në Londër dhe gjatë krahasimit me botimet e shtypura.

Pavarësisht nga lëkundjet e dorëshkrimit, krahasimi me botimin e Mateut më 1824 na jep ndryshime të ndjeshme. B më 1824 është dhënë dyfishtë $\beta\beta$ në vend të *b* të Meksit; Meksi ka ϵ për *e*, dhe *e* për ϵ , për *g* dhe *gj* ka γ dhe kombinime me *k*, duke u lexuar sipas pozicionit si në greqishten; për *ll* ka dy llanda greke $\lambda\lambda$, për *nj* ka ν , për *u* ka \varnothing , kurse për *y* i shton një pikë sipër, për togjet *mb*, *nd*, *ngj*, *st*, *ks* ka kombinime të tjera etj. Me një studim të plotë të dorëshkrimit mund të përcaktohet përfundimisht alfabeti i Meksit, i cili pra ndryshon nga ai i botimeve më 1824 e 1827.

Pas alfabetit, çështja themelore gjatë përkthimit ka qenë karakteri i gjuhës. Cila do të ishte gjuha e përkthimit? Kundrejt një përkthimi të tillë shtrohej kërkesa, që gjuha të ishte e kuptueshme për një masë sa më të gjërë lexuesish. Përfaqësuesit e Shoqërisë biblike përpiqeshin gjithnjë të gjenin njerëz, që tashmë ishin bërë të njohur me punën e tyre, pastaj kërkonin një rishikim të kujdesshëm të përkthimit dhe, së fundi edhe pas botimit vijonin të verifikonin shkallën e të kuptuarit të botimit. Prandaj që në pikën e parë të marrëveshjes (dok. I) theksohet se përkthimi do të jetë në gjuhën shqipe ashtu siç fli-tet në Janinë, dhe ritheksohet, që ajo të jetë sa më e saktë. Ishte koha e Ali Pashë Tepelenës dhe gjuha e Janinës merret si model, si një farë koineje. Ideja e një modeli për një gjuhë të përbashkët të shkruar na del që në këtë kohë dhe gjuha e Janinës vlerësohet siç do të vlerësohet më vonë «shqipja e Elbasanit».

Për rishikimin e përkthimit janë bërë përpjekje të gjendeshin njerëz të ndryshëm. Në marrëveshje është përcaktuar që do ta bëjnë dy klerikë shqiptarë të arësimuar. Këtë e ka përfshirë në marrëveshje R. Pinkertoni, i cili i qe drejtuar patriarkut të Stambollit për t'i gjetur ekleziastë të ushtruar mirë në gjuhën shqipe, me qëllim që ta ndihmonin Meksin në punën e tij për ta bërë versionin sa më të përsosur. Kur ishte në Selanik në fillim të vitit 1821, Hilarioni (përkthyesi i Dhjatës në greqishten e re) i ka shkruar një letër Meksit të kthehej në Stamboll për të bërë një marrëveshje tjetër lidhur me rishikimin. Një njeri mjaft kompetent gjendej atëhere në manastirin

e patriarkanës së Jerusalemit. Të gjitha këto dëshmojnë se numri i shqiptarëve me pregatitje të mjaftë për të bërë një punë të tillë nuk ishte i vogël, mbetej të përcaktohej cili do të ishte më i përshtatshëm.

Edhe pasi ju besua G. Gjirokastritit, diskutimi për gjuhën ka vijuar. Më 1824 Laundzi ua ka treguar përkthimin 4 shqiptarëve në Korfuz, të cilët kanë thënë se kuptimi është dhënë drejt. Në shtator ai i bën një propozim Komitetit në Londër të ndërmarrë një udhëtim në Shqipëri për të verifikuar karakterin e punës dhe vetëm gjendja e brendshme e vendit nuk e ka lejuar, mbasi turqit ishin duke ngritur trupa kudo. Më 1826 një grek ka vizituar Kavajën, Durrësin dhe Shkodrën. Përshtypjet e veta ja ka dërguar në një letër Laundzit, dhe ndër të tjera thekson për përkthimin e Mateut: «Dialekti në të cilin ai është përkthyer, sipas mendimit të disa njerëzve të mësuar, është mjaft i ndryshëm nga ai që flitet në Durrës dhe në pjesën veriore të Shqipërisë. Megjithatë ai flitet në të gjithë Epirin dhe ortodoksët që banojnë në Shkodër e kuptojnë në mënyrë të mjaftueshme». Po ai tregon se priftërinjtë katolikë përdorin latinishten në ceremonitë e ndryshme, por nganjëherë e shpjegojnë Ungjillin shqip, duke dhënë udhëzime të ndryshme dhe njerëzit janë të detyruar që rrëfimin ta bëjnë shqip. Vetëm nëpër disa qytete kryesore, si në Shkodër, për shkak të tregëtisë me Venedikun dhe porte të tjera të Italisë, tregëtarët e kuptojnë italishten. «Kam takuar shumë vetë, të cilët për të shkruar letrat e tyre të korrespondencës përdorin shkronjat italiane, duke ju shtuar disa shenja që i kanë për të shprehur tingujt e veçantë të gjuhës shqipe». Këto të dhëna janë me interes për të kuptuar përse njerëzit e thjeshtë e prisnin me gëzim çdo faqe të shkruar shqip.

Përmendëm më lart fjalët e H. Livzit për gjuhën e përkthimit në letrën e 24 majit 1832.

Çështja e gjuhës ka dalë edhe një herë në dritë 30 vjet pas botimit, kur u shtrua pyetja, a do të bëhej një ribotim, apo një përkthim i ri. C. Hamlin më 17 mars 1857 shkruan se përkthimi është në dialektin e Hidrës dhe është përshtatur për popullsinë e saj e jo për Shqipërinë në tërësi (dok. IX). Këtë letër e dërgon në Londër B. Barker më 20 mars (dok. X), duke shtuar nga ana e vet se është një dialekt i prishur, i përdorur vetëm në disa ishuj. Për fat të keq, aty nuk thuhet se nga cila krahinë ishte kasapi, të cilit ja kishin treguar përkthimin për ta parë se sa e kuptonte, po me sa duket, do të ketë qenë nga veriu. Letra e Hamlinit i është dërguar edhe Laundzit në Maltë, i cili në përgjigjen e shkruar për Londrën më 13 prill 1857 jep disa shpjegime më të hollësishme, prandaj e sjellim të plotë (dok. IV.) Laundzi paraqet si argumenta ndryshimet dialektore që ka çdo gjuhë, miratimin e gjuhës nga vetë shqiptarët e Korfuzit dhe së fundi mendimin e Hahnit, i cili e ka shqyrtuar përkthimin dhe e ka quajtur shumë të mirë. Laundzi në veçanti kundërshton aty mendimin e Kristoforidhit. Siç do të sqarohet më tej, Kristoforidhi ishte i detyruar të mbronte nevojën e përkthimeve të reja duke u shprehur disa herë në mënyrë negative (dok. VI, VIII) mbi variantin e Meksit, megjithëse në thelb ai e pranonte që shqipërimi ishte bërë mjaft mirë.

Së fundi, A. Tomsoni më 1877 do të konstatojë se përkthimi i vitit 1827 nuk është bërë nga origjinali greqisht, por nga versioni i vje-

tër i përkthimit në greqishten e re, të cilin e shoqëronte dhe të cilin e ka ndjekur fjalë për fjalë. Po ai më 1882 na përmend një letër që ka marrë nga Dh. Kamarda, i cili i është shprehur me fjalë të larta për versionin e Meksit dhe i vinte keq, që nuk ishte vijuar ajo ortografi.

U përmendën të gjitha këto hollësi, sepse do të ndihmonin mjaft po të bëhej një studim i dorëshkrimit të Londrës nga pikëpamja e dialektologjisë historike. Shqyrtimi i hollësishëm do të sqarojë kriteret e përkthimit të V. Meksit, njohjen e traditës dhe shfrytëzimin e saj. Kështu p.sh. në vend të *krie* që ka përdorur Gjirokastriti, dorëshkrimi kishte *kaptirë*, një trajtë me interes nga kjo pikëpamje. Po të vështrohen këto në tërësinë e tyre, duke shtuar edhe formimin e Meksit, udhëtimet e tij në shumë vende, përpjekjet e ndërjegjshme për ta njohur shqipen edhe teorikisht, atëhere kemi të drejtë të mendojmë se gjuha e tij sidoqoftë ka një karakter më të përgjithshëm e më të punuar; me këtë përlijet vlerësimi i madh që i është bërë veprës për gjuhën shqipe në tërësi, siç doli në dukje në hyrje.

d. Përfundime.

Autorësia e përkthimit mund të quhet tashmë e përcaktuar përfundimisht me gjetjen e marrëveshjes së nënshkruar, të kopjes së plotë të dorëshkrimit dhe të korrespondencës përkatëse. Përkthimin V. Meksi e ka përfunduar në rreth 15 muaj dhe ai u përket viteve 1819-1820. Po të kujtojmë rrethanat e fillimit të shekullit të kaluar, kur nuk kishte shkolla shqipe, kur mungonte jo vetëm një letërsi e gjerë shqipe, por as çështja e alfabetit nuk ishte e zgjidhur, atëhere kuptohet se një punë të tillë mund ta bënte vetëm një njeri, që kishte menduar me kohë për shkrimin e shqipes²⁵ e që ndoshta ishte njohur me diçka nga tradita. Vërtetimi më i mirë i kësaj janë jo thjesht fjalët e R. Pinkertonit, se atë ja kanë rekomanduar si një njeri me cilësi të shquara për këtë punë, por një fakt tjetër më i rëndësishëm: «Ai tashmë ka shkruar një gramatikë në gjuhën e vet amtare, të cilën ma tregoi.» (letra e 25 tetorit 1819). Për këtë gramatikë nuk dimë më tepër se kaq, por me të kuadri bëhet i plotë: V. Meksi e ka studjuar gjuhën e vet, ka përcaktuar një alfabet dhe një drejtshkrim, ka gjetur fjalët e nevojshme për të zgjidhur detyrat e vështira të një përkthimi të tillë, duke na lënë një dokument të gjerë për një gjuhë të punuar e të pasur, vlerën e të cilit prandaj me të drejtë e kanë çmuar studjuesit.

II. Grigor Gjirokastriti.

Të dhënat më të plota për Grigor Gjirokastritin i kemi nga A. Xhuvani²⁶. Në mënyrë të përmbledhur ato paraqiten edhe në «Historinë e letërsisë shqipe», ku zotëron mendimi se G. Gjirokastriti ka qenë përkthyes dhe gjuha e përdorur cilësohet si një toskërishte e tij,

25) Tërthorazi këtë e dëshmon e dhëna e T. Evangjelidhit se V. Meksi kishte bërë disa përkthime, të shtypura në Venetik më 1814; shih I. M. Qafëzezi, *vep. cit.*

26) A. Xhuvani, *Grigor Gjirokastriti*, në «Shkrimtarët shqiptarë», pj. I, T. 1941, f. 88-93.

e thjeshtë, e kuptueshme për popullin²⁷. Ne tashti kemi mundësinë të përcaktojmë me saktësi punën që ka bërë Gjirokastriti, duke krahasuar dorëshkrimin e Londrës me botimin. Në dorëshkrim ka disa nënvizime, të cilat nga një vështrim i shpejtë që u kemi bërë, dalin se janë pikërisht në pjesët e ndryshuara në botim, rrjedhimisht mund të jenë nënvizime të vetë Gjirokastritit. Sidoqoftë kjo kërkon një studim të imtë, i cili do të jetë me interes për të parë punën e një redaktori shqiptar, ndoshta të parit në fillim të shekullit XIX. Nga karakteri sistematik i ndreqjeve do të nxirreshin edhe kriteret gjuhësore të redaktimit. Këtu do të kufizohemi ta shohim punën e G. Gjirokastritit në bazë të të dhënave dokumentare.

a. Botimi i vitit 1824.

Në maj të vitit 1823 përfaqësuesi i BFBS në Stamboll, H.D. Livz mori udhëzime që të dërgonte në Korfuz një kopje të Mateut me qëllim që të shtypej atje nën drejtimin e Shoqërisë biblike joniane (Ionian Bible Society). Kopjen e mori I. Laundzi, i cili ishte në atë kohë sekretar i kësaj shoqërie. Rrjedhimisht, puna për redaktimin e Mateut ka filluar gjatë majit 1823. Nga një shënim i H.D. Livzit i datës 5 qershor 1823 del se përgatitja kishte filluar tashmë. Kjo përputhet me të dhënë e A. Xhuvanit, se deri në prill 1821 Gjirokastriti ka qenë në Eube, pastaj i burgosur 2 vjet për shkak të pjesëmarrjes në një lëvizje, dhe pas lirit zuri vend në Korfuz.

Më 16 mars 1824 është bërë një mbledhje e Komitetit të Shoqërisë joniane dhe po atë ditë Laundzi i ka shkruar Londrës një letër (dok. V). Rishikimi i Mateut kishte mbaruar dhe në letër thuhet qartë se kjo është punë e Gjirokastritit, duke saktësuar dhe pagesën për të. Vendasit e tjerë shqiptarë e kanë parë punën dhe kanë shprehur miratimin e tyre. Gjirokastriti gjithashtu ka ngulur këmbë që shtypja të bëhej në shtylla paralele jo me tekstin në greqishten e vjetër, por në greqishten e re dhe, kundër dëshirës së Laundzit, kjo është pranuar.

Shtypja e librit ka filluar në mars 1824. Mirëpo menjëherë lindën vështirësi në përshtatjen e shkronjave greke për tekstin shqip. Prandaj me t'u shtypur fleta e parë dhe e shtatë tipografike, Laundzi i ka dërguar në Londër për të marrë një mendim. Me ato është marrë T. Plat, i cili ka pasur një korrespondencë të gjatë me Laundzin për alfabetin. Siç del, Plati nuk e dinte shqipen, por njihte fjalorin e F. Bardhit, gramatikën e Maria da Leças dhe disa nga botimet e tjera shqip me alfabetin latin. Në letrën e tij të datës 30 qershor 1824 shqyrtohen zgjidhjet e dhëna nga Laundzi, të cilat janë kështu në fakt ndryshimet që i ka bërë Laundzi alfabetit të V. Meksit. Me fjalë të tjera, botimi i vitit 1824 është me alfabetin e V. Meksit, të ndryshuar në disa raste nga Laundzi për nevoja të shtypjes. Vështirësitë kryesore i kanë paraqitur tingujt *sh*, *ç*, *b*, *d* (dhe togjet *mb*, *nd*), *h* dhe *u*. Në një letër të gjatë përgjegjeje të datës 2 gusht 1824 Laundzi shpjegon arësyet përse i ka pranuar ndryshimet. Të dhëna të tjera ka edhe në letrën e 12 dhjetorit 1867 (dok. III). Përsëri Laundzi këtu i ka nga-

22) *Vep. cit.*, f. 323.

tërruar pak gjërat, për shembull, korrespondencën me Platin e ka pasur që më 1824 edhe për botimin e Mateut. Por ajo që ka vlerë për ne është se ai ndryshimet në alfabet i ka bërë duke u këshilluar me shqiptarët në Korfuz, gjë e kuptueshme, pasi Laundzi vetë nuk e njih-te mirë shqipen. Kjo përputhet me një frazë në letrën e 2 gushtit 1824, ku ai thekson se trajtat e shkronjave nuk janë të tija vetë, me ndo-një përjashtim.

Më 5 shtator 1824 shtypja e librit mbaroi. Ky botim ishte një provë përpara botimit të plotë të përkthimit. Laundzi dëshironte ta ve-rifikonte punën në Shqipëri dhe në pamundësi të udhëtojë vetë, ka mbledhur njoftime të tjera. Në një letër të 6 majit 1825 ai na tregon se u kishte shkruar shqiptarëve në Misolongji dhe ka marrë vesh se përkthimi është pritur me kënaqësi e gëzim të madh dhe kur bie dita për të lexuar Mateun, atë e lexojnë rregullisht shqip dhe jo greqisht. Gjithashtu udhëtari grek që përmendëm më 1826, ka ta-kuar famullitarin e Durrësit e të Kavajës, Andrea Konomin, i cili «ndjeu një gëzim të pamasë e të papërshekruar, kur e mori fjalën në një gjuhë të kuptueshme».

b. Botimi i plotë, 1827.

Në gusht 1824 kopja e plotë e dorëshkrimit të Meksit tashmë kishte ardhur në Korfuz dhe G. Gjirokastriti ka filluar menjëherë rishikimin. Më 8 gusht Laundzi kishte marrë një letër nga Livzi prej Stambolli, i cili për ta ndihmuar në përshtatjen e alfabetit grek për shqipen, i kishte dërguar një përkthim turqisht me shkronja greke, ku për *b* ishte përdorur π , për *d*- δ dhe për *sh*- σ . Këtë zgjidhje Laundzi e ka pranuar si më të përshtatshme, prandaj «kryepeshkopi po i përdor ato gjatë rishikimit». Laundzi ka përdorur pikërisht fjalën *rishikimin*. Në dhjetor të vitit 1824, rishikimi i gjithë Dhjatës së re kishte përfunduar, pra ka vijuar rreth 5 muaj, një periudhë relativisht e shkurtër. Menjëherë në fillim të vitit 1825 filluan përgatitjet për shtypjen. U bënë shkronja të reja plotësuese për shtypshkronjën, por ndër kohë një farë Kastro, i kualifikuar për prerjen e shkronjave, u dërgua në Korfuz me rekomandimin e Livzit dhe përgatiti një seri të re të plotë. Në një letër të 6 majit 1825 Laundzi i jep të nëntë shkronjat e reja, që u përgatitën për tingujt *b, d, g, h, k, sh, nj, l* dhe *u*. Ato janë shënuar më vonë në kapak të botimit.

Pas përfundimit të rishikimit në dhjetor 1824 Grigor Gjirokastriti vijonte të qëndronte në Korfuz, prandaj në një letër të 21 tetorit 1825 Laundzi kërkon lejen për ta angazhuar në korrektimin e shtypit. Kjo leje ju dha duke ju caktuar një shumë deri 30 dollarë spanjollë në muaj. Laundzi i ka paguar Gjirokastritit 20 dollarë dhe i shkruan BFBS se e ka bërë këtë në interes të Shoqërisë!

Në shkurt 1826 fleta e parë tipografike ishte gati. Në qershor, me qenë se puna po shkonte mbarë, lindi çështja e lidhjes së librit. Më 5 qershor 1826 Laundzi shkruan: «Kryepeshkopi ka thënë disa herë që do të ishte më mirë të lidhej Dhjata në dy vëllime, vëllimi i parë të përmbante katër ungjijtë dhe i dyti pjesën tjetër të Dhjatës, meqë shqiptarët e kanë zakon t'i mbajnë librat me vete në gji.» Në

mbledhjen e 13 korrikut 1827 Komiteti në Londër mori këtë vendim: «T'i kërkohet Komitetit të Shoqërisë biblike joniane që 500 kopje të Dhjatës shqip e në greqishten e re të lidhen në dy vëllime, në përputhje me rekomandimin e kryepeshkopit.» Në prill Laundzi kishte dërguar në Londër dy kopje të shtypura deri tek Veprat, për të treguar cilësinë e punës së bërë.

Në fund të marsit 1827 Grigor Gjirokastriti e ka ndërprerë punën dhe ka ikur nga Korfuzi për në ishullin Scio të arkipelagut të Egjeut. «Po të kishte ikur ai më parë, — shkruan Laundzi më 11 qershor, — Dhjata shqip nuk do të ishte shtypur dot, por perëndia me providencën e vet urdhëroi që ai të qëndronte këtu deri në atë kohë, sa prania e tij të mos ishte më absolutisht e nevojshme. Ai ka udhëzuar një të ri për shqipen, për korrekturat etj. pasi e kishte përgatitur vetë plotësisht dorëshkrimin dhe ne tashti mund të ecim pa ndihmën e tij». Më 10 gusht kanë mbaruar së shtypuri fletët e fundit. Po ashtu ishin pothuaj gati 500 kopje të lidhura në dy vëllime dhe po lidheshin në një vëllim 150 kopje të tjera.

Laundzi shkruan më 12 nëntor 1827: «Kryepeshkopi Grigor me shtytjen time, i ka kushtuar shumë vëmendje rishikimit të dorëshkrimit, në mënyrë që ai t'i ngjasë tekstit grek pa shtojca ose ndryshime dhe banorët e Shqipërisë e kuptojnë». Pothuaj gjysmë shekulli më vonë do të zbulohet që kjo nuk është kështu, gjë që ka një paralele tjetër të tillë në përkthimet e Kristoforidhit. Përfaqësuesi i BFBS në Stamboll Sellar më 4 maj 1875 ka dërguar një letër, në të cilën thuhet që teksti shqip «në dialektin e jugut predikon herezi... i gjithë libri është i mbushur me paranteza, të cilat kushedi se çfarë kanë brenda». Sellari menjëherë e ndaloi qarkullimin e Mateut të vitit 1824. Komiteti në Londër vendosi që të përgatiteshin korigjimet, duke hequr të gjitha fjalët e papërshtatshme, dhe të bëheshin në të gjitha kopjet e Dhjatës toskërisht, që ende nuk ishin shitur. Kjo tregon se si përkthimi i Meksit, ashtu edhe redaktimi i Gjirokastritit kanë synuar të ishin të kuptueshëm për njerëzit e thjeshtë, pavarësisht nga kërkesat dogmatike në rastet e përkthimeve të tilla. Gjatë udhëtimit më 1832 Livzi ka marrë me vete 22 copë të këtij botimi dhe ja ka lënë peshkopit të Drinopullit, i cili, ka thënë se do t'u kërkojë gjithë priftërinjve të vet shqiptarë të pajisen me nga një kopje. gjithashtu do t'i dërgonte disa kopje kryepeshkopit të Beratit. Megjithatë libri nuk u shit menjëherë, siç e tregon fakti që për 30 vjet ka pasur ende kopje. Kjo shpjegohet me ndjekjet e egra të patrikanës greke kundër fjalës shqipe (dok. IX).

C. Botimi i vitit 1858

Me qenë se kemi të bëjmë me po atë tekst, po japim disa njoftime, që dalin nga dokumentat për ribotimin.

Në fillim të vitit 1856 I. Laundzi mendon të botojë sërish Dhjatën e re shqip. Në një letër të 25 shkurtit ai shkruan se shpreson të vizitojë Shqipërinë dhe të rregullojë diçka. I bën një letër botuesit Kristo Nikolaides në Athinë dhe në dhjetor (dok. IV) nisët nga Malta për në Athinë. Pikërisht në këtë kohë misionarët amerikanë në Stam-

boll kanë filluar përçapjet e tyre dhe prandaj ndeshen ideja e një ribotimi me idenë e ripërktimit. I. Laundzi me këmbënguljen kokëfortë që spikat në të gjitha materialet e tij, e çon deri në fund shtypjen. Mirëpo këtë radhë botimi është pa mbikqyrjen e ndonjë shqiptari, prandaj del me shumë të meta. Në vendimin e Komitetit në Londër në dhjetor 1859 thuhet se, për këtë arsye, kopjet nuk duhen tërhequr për t'i vënë në qarkullim.

d. *Botuesi.*

Grigor Gjirokastriti ka punuar për botimin e *Mateut* dhe të *Dhjatës së plotë* nga maji 1823 deri në fund të marsit 1827. Pas redaktimit të *Mateut*, ai ka punuar si mbikqyrës dhe korrektor i shtypit. Siç e thotë Laundzi (2 gusht 1824), në dorëshkrim ai i kishte ndarë në rregull fjalët, por gjatë korrekturave në fillim nuk ishte i saktë, sepse nuk kishte pasur rastin asnjëherë më parë të merrej me një punë të tillë. Pak nga pak e përvetësoi teknikën dhe Laundzi shkruan (31 tetor 1825): «Nuk njoh njeri tjetër, si ai për të korrektuar shqipen, mbasi ai e ka rishikuar, e njeh ortografinë etj. Ai është shumë i aftë për të punuar edhe si njëri prej korrektorëve të greqishtes së re.»

Por kushtet në të cilat ai ka punuar, kanë qenë mjaft të rënda. «Ai është ende këtu, por në nevojë kaq të madhe, sa që tashti së fundi vendosi të shkojë midis turqve, por unë i kërkoja të qëndronte, duke i thënë se shpresoja që do të shtypej *Dhjata* shqip. Më pikon në zemër për një njeri kaq të nderuar sa ai dhe kaq të dërmuar... Diçka e përmuajshme, e mjaftë sa për të përballuar jetën, do të ishte një bamirësi e madhe dhe nga ana e Shoqërisë biblike do të ishte vetëm një pagesë për aq sa duhet paguar dhe që pa kryepeshkopin nuk do të bëhej mirë... Përndryshe, kryepeshkopi do të ikë, gjë që do të jetë një humbje mjaft serioze». (po aty). Prandaj Gjirokastriti ka pranuar ta bëjë ndreqjen me 20 dollarë spanjollë në muaj, por me rastin më të parë do ta braktiste. Besojmë se kështu shpjegohet largimi i tij para përfundimit të shtypjes, megjithëse duhet përmendur kujdesi i tij për të përgatitur një të ri që ta zëvendësonte.

e. *Përfundime.*

Me termat e sotëm mund të themi se G. Gjirokastriti ka qenë një redaktor dhe korrektor letrar i botimit. Për gjuhën e përkthimit kjo do të thotë se aty ka disa ndryshime, gjithnjë brenda të folmeve nga krahina e Gjirokastrës, por si një mbishtresim mbi gjuhën e Meksit. Kështu shpjegohen qëndrimet e ndryshme që kanë mbajtur studjuesit e mëvonshëm gjatë përcaktimit të veçorive dialektore të veprës.

Puna e redaktorit nënkupton një njohje të mirë të gjuhës, aftësi letrare, kujdes dhe vëmendje, cilësi të cilat Grigor Gjirokastriti pa dyshim i ka pasur, për deri sa kjo punë ju besua atij pas kaq kërkimesh. Kërkesat e tij këmbëngulëse kundrejt botimit dëshmojnë se ai ka qenë një njohës i mirë i gjendjes së formimit kultural të shqiptarëve të kohës dhe mund të përsërisim thënien e tij se «shqiptarët e kanë zakon t'i mbajnë librat në gji.»

Dok. I

Marrëveshja për përkthimin e Vangjel Meksit.

U lexua marrëveshja e bërë nga Dr. Pinkerton me Vangjel Meksin lidhur me një version të Shkrimeve të shenjta në gjuhën shqipe, e cila u aprovua nga ky Komitet si më poshtë:

«Marrëveshje lidhur me përkthimin e Dhjatës së re nga teksti i greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe shënuar D.

1. Dr. Vangjel Meksi zotohet të përkthejë Dhjatën e re nga teksti në greqishten e vjetër në gjuhën shqipe, ashtu siç flitet në Janinë dhe për këtë punë ai do të marrë shumën gjashtë mijë piastra.

2. Sapo dr. Meksi të ketë përkthyer dy Ungjijtë e parë dhe të paraqesë dorëshkrimin të shoqëruar nga një vërtetim i arkimandritit Hilarion, që të dëshmojë se përkthimi është bërë në përputhje me marrëveshjen e mësipërme, ai do të marrë shumën një mijë e pesëqind piastra turke; kur ai të dorëzojë dy Ungjijtë e tjerë në po atë mënyrë do të marrë një mijë piastra; kur të ketë mbaruar përkthimin e Veprave të apostujve bashkë me Letrat e Shën Palit për romakët, për korintianët dhe për galatianët dhe këto të kenë marrë aprovimin e arkimandritit Hilarion, ai do të marrë shumën një mijë e pesëqind piastra; dhe kur Letrat e tjera dhe Apokalipsi do të përkthehen dhe korrektësia e tyre të verifikohet nga arkimandriti i përmendur, ai do të marrë shumën që mbetet prej dy mijë piastra.

3. Dr. Vangjel Meksi jo vetëm zotohet të ushtrojë gjithë aftësitë e tij për ta bërë përkthimin besnik dhe në përputhje me tekstin, por njëkohësisht t'ja nënshtrojë rishikimit nga dy klerikë shqiptarë të arësiumuar, me qëllim që të ushtrohet çdo kujdes i mundshëm për ta bërë gjuhën të saktë dhe të përshtatshme me idiomën e shqiptarëve ashtu siç flitet në Janinë dhe të lehtë për t'u kuptuar nga kombet për të cilët është përcaktuar, përpara se sa të jepet në shtyp.

(Nënshkruar) Robert Pinkerton.
Vangjel Meksi (Ex Greece)

Stamboll, 19 tetor 1819.

Dok. II.

Letër e R. Pinkerton, Vienë, 28 gusht 1816.

Pajisja e shqiptarëve të paktën me një Dhjatë të re në gjuhën e tyre, është një qëllim që e meriton vëmendjen e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja. Ky komb zë një pjesë të madhe të Ilirisë së lashtë e të Epirit dhe flet një gjuhë që, siç duket, nuk ka afëri gramatikore me sllavishten, turqishten, greqishten ose latinishten. Shumë nga shqiptarët janë të krishterë që i përkasin kishës greke, të tjerët janë zhytur kaq shumë në padijen e parimeve të krishterimit, sa që kanë përqaftuar besimin mysliman. Shërbesat i bëjnë në gjuhën greke, e cila është krejt e pakuptueshme për popullin dhe madje për shumë nga priftërinjtë. Ata ende nuk kanë ndonjë pjesë të fjalës së Zotit në gjuhën e tyre; numri i tyre nuk dihet me saktësi, po llogaritet të jenë midis 8 e 900.000 shpirt. Mbas shumë hetimesh unë e shoh se një përkthim i Dhjatës së re në gjuhën shqipe mund të bëhet

nga ndonjë njeri ose disa vetë në Ishujt Jonianë. Nga bisedat që kam patur me disa shqiptarë të zotët, këtu, unë nuk kam dyshim se mund të gjenden atje njerëz të aftë për këtë detyrë. Puna duhet të bëhet nën mbikqyrjen e njerit nga peshkopët shqiptarë më të mësuar e më të respektuar dhe shpenzimet si të përkthimit, edhe të shtypjes duhet të paguhen nga Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja. Në rast se do të vendoset një Shoqëri Biblike në ndonjërin nga Ishujt Jonianë, dhënia shqiptarëve e Dhjatës së re në gjuhën e tyre me siguri do të ishte një qëllim që do të meritonte përpjekjet e saja më të para dhe shumë të zellshme. Është e vërtetë, se relativisht shumë pak njerëz dinë të lexojnë, por edhe pa përmendur që kështu ata mund të shtyhen të mësojnë, çfarë pasurie e paçmuar do të ishte një Dhjatë shqip qoftë vetëm për priftërinjtë e tyre të shumtë, pjesa më e madhe e të cilëve janë të dënuar t'i lexojnë shërbesat e kishës së tyre gjatë gjithë jetës në një gjuhë, që ata nuk e kuptojnë! Në rast se kjo punë do të ndërmerret, duhet të shtypet me shkronja greke, mbasi alfabeti grek, duke ju shtuar vetëm pak tinguj, është më i mirë për të shprehur gjuhën shqipe, dhe duke përdorur alfabetin grek në vend të latinut, të gjithë ata midis tyre që dinë të lexojnë, do të jenë në gjendje menjëherë të përdorin Dhjatën tuaj shqip.

Dok. III

Letër e I. Lowndes për H. Knolleke

Sh. Agnes, 12 dhjetor 1867.

Dje mora letrën tuaj për çështjen e broshurave shqip të botuara në Korfuz dhe do të isha i lumtur t'u jepja atë informacion, që do të plotësonte dëshirën tuaj, po të kisha mundësitë. E vetmja shpresë mbetet t'i shkruani H.C. Reichardt, misionar i Shoqërisë hebraike të Londrës, që tashti është në Korfuz. Në rast se ai do të bënte hetime të kujdesshme, ka mjaft mundësi që mund të gjente diçka duke pyetur shqiptarët, të cilët mund të jenë në Korfuz, ose vendasit e atjeshëm. Por gjëja më e mirë do të ishte të hetohej në zyrën shtetërore të shtypit. Ka mundësi që disa modele të jenë lënë atje dhe mund të jenë akoma në zyrën aty. Lidhur me këtë çështje, unë do të jap disa shënime, mbasi çdo gjë lidhur me shtypjen shqip në Korfuz është bërë me drejtimin tim dhe nën mbikqyrjen time. Dr. Pinkerton, agjent i BFBS gjatë një udhëtimi në Mesdhe e gjetkë, takoi diku një dr. Meksi, vendas nga Shqipëria dhe bëri një marrëveshje me të për të përkthyer Dhjatën e re në gjuhën shqipe. Kjo mund të ketë qenë në vitin 1821 ose 1822. Ai e filloi punën, por vdiq përpara se ta përfundonte. Dorëshkrimet e tij m'i dërguan mua në Korfuz, me qëllim që të shtypeshin atje. Por meqë nuk ishin të plota dhe ishin në çrregullim të madh, e pashë se ishte jashtë diskutimit t'i jepje për në shtyp. Një vërejtje tjetër materiale ishte se dr. Meksi kishte përdorur alfabetin latin. Në atë kohë kishte shumë vendas nga Shqipëria në Korfuz, njëri me një farë njohurie në punën e shtypit dhe gjithashtu peshkop i kishës greke, gjë që ishte edhe më e favorshme.

Ai m'u duk shumë dashamirë dhe i gatshëm për të dhënë ndihmën e vet për këtë çështje. Unë hyra në marrëdhënie të plota me këta shqiptarë dhe të gjithë erdhëm në përfundimin, që do të ishte krejt pa vend ta shtypnim Dhjatën shqip me shkronja latine, mbasi do të duhej të bëheshin aq shumë kombinime të reja në ortografi, sa që njerëzit në përgjithësi të panjohur me këtë alfabet, do ta kishin shumë të vështirë të kuptonin këto kombinime, po që se do të kishin dëshirë t'i studjonin, gjë që do të ishte me pikëpyetje. Meqë ishte e qartë që shkronjat latine do të ishin pengesë në rrugë, mënyra e vetme që mund të zbatohet ishte të përdorej alfabeti grek, të cilin shqiptarët e përdornin dhe që afrohet më tepër, duke shprehur tingujt e veçantë, të cilët nuk mund t'i japë alfabeti latin. Megjithatë nga shqyrtimi doli se kishte nëntë tinguj në gjuhën shqipe, që shkronjat greke të pakombinuara nuk i shprehnin dot dhe atëherë lindi pyetja çfarë duhej bërë për ta përballuar këtë vështirësi. Ose duheshin pranuar disa kombinime shkronjash, ose duheshin shpikur shkronja të reja për këtë qëllim. Kjo e fundit doli më e këshillueshme. Më 1825 për këtë çështje shkëmbyem disa letra unë dhe z. Platt, i cili ishte i ngarkuar në Shoqërinë biblike. Më në fund unë i formulova dhe ja dërgova z. P. për t'i shqyrtuar shkronjat e reja plotësuese që kisha propozuar t'i shtoheshin alfabetit grek, me qëllim që të formohej një alfabet shqiptar. Ai i miratoi ashtu siç i kisha rregulluar unë e kështu u përfundua kjo. Unë menjëherë dhashë udhëzimet për të bërë matricat për këto shkronja të reja dhe të derdheshin shkronjat. Peshkopi shqiptar i kishës greke ndërmoi përkthimin e Dhjatës së re duke përdorur alfabetin shqiptar. Ai u dha në shtyp më 1826 dhe përfundoi më 1827. Matricat që bëra unë janë tashti në depozitën në Maltë, së bashku me të tjerat për gjuhën greke, që m'u dërguan nga Stambolli prej z. Leeves. Jam i gëzuar që po marr vesh se ju ka bërë vizitë një shqiptar i mësuar, i cili ka dhënë dëshmi për mjeshtrinë e lartë të përkthimit të Dhjatës së re në gjuhën shqipe. Kjo është një dëshmi më tepër mbi shumë të tjera. Lidhur me të sidoqoftë unë mendoj se është pak si tepër e ngritur për njerëzit e zakonshëm. Por unë nuk e quaj aspak një të metë këtë. I vetmi njeri që kam takuar, i cili ka bërë vërejtje, është Kristoforidhi. Edhe ai nuk është ankuar për përkthimin, por që nuk është në shqipen e mirëfilltë, domethënë në dialektin me të cilin ai është më tepër i familjarizuar. Përsa di unë, dialekti i tij mund të jetë më i përhapur, por kam takuar shqiptarë që banojnë në Korfuz, në Shqipërinë e mirëfilltë dhe në disa nga ishujt e Arkipelagut ku ka mjaft, dhe në të gjitha këto raste Dhjata e re e botuar në Korfuz kuptohet mirë. Përpara se të botohej Dhjata e re, besoj se kam shtypur edhe dy broshura dhe një botim të vogël të Ungjillit të Sh. Mateut, këtë të fundit në shtylla çift, greqishte e re dhe shqip. Megjithatë kjo është bërë para se të formohej alfabeti shqiptar dhe prandaj janë përdorur kombinime të shkronjave greke për të shprehur tingujt e veçantë të shqipes, por tashti nuk më kujtohet çfarë kombinimesh kam përdorur. Do të isha shumë mirënjohës sikur të gjendeshin kopje të këtyre, ndonëse ortografia do të dilte shumë e ndryshme nga ajo në Dhjatën e re. Këtë të fundit besoj se e keni në Bibliotekë në Londër. Një botim i dytë

është shtypur vite më vonë, në Athinë. Por i pari është më i miri dhe më i sakti. Për mua nuk ka kënaqësi më të madhe, se sa të ndihmoj dhe të bëj përpjekje për të ndihmuar interesat e Shoqërisë biblike.
(nënshkruar) I. Lowndes.

Z. Reichardt nuk ka qëndruar në Korfuz më shumë se pesë vjet. Alfabeti shqip e paraprin Dhjatën e re shqip.

Dok. IV.

Letër i I. Lowndes nga Malta, 13 prill 1857.

Dje mora një letër nga z. Knolleke, të shoqëruar nga një kopje e një letre që ju është dërguar prej dr. Hamlin nga Bebeku dhe që më kërkon të jap mendimin për këtë çështje sa më shpejt të kem mundësi. Po e bëj këtë me rastin më të parë që po më del dhe nuk di të ketë mënyrë më të përshtatshme, se sa t'u dërgoj kopjen e një letre, që i kam shkruar z. Barker, i cili më ka dërguar një kopje të letrës së z. Hamlin për ju. Letra ime është si vijon:

11 prill 1857.

Z. Barker,

I nderuar zotni,

Letra juaj e datës 31 të muajit të kaluar më erdhi më 8 të muajit në vazhdim, e shoqëruar me një kopje të letrës nga dr. Hamlin për Z. Bergne, lidhur me çështjen e një përkthimi të ri të Shkrimeve të shenjta në gjuhën shqipe, duke u mbështetur në supozimin se përkthimi që është në qarkullim, nuk kuptohet nga popullsia e Shqipërisë në tërësi, mbasi është në dialektin e Hidras.

Unë jam i lumtur kur marr vesh çdo rast që fjala e Zotit është përkthyer në një gjuhë, në të cilën nuk njihej më parë dhe lutem që të ketë bekimin me vete, prandaj do të bëj vërejtje vetëm për frazën «Nuk kuptohet nga popullsia e Shqipërisë në tërësi». Kjo është njësoj si të thuhet, që një përkthim në portugalisht nuk do të kuptohet nga popullsia e Francës në tërësi. Gjuha shqipe, e marrë në të gjithë shtrirjen e saj, është shumë më pak një e vetme se portugalishtja dhe frengjishtja. Unë do të mendoja nga një vërejtje në letrën e dr. Hamlin, se njeriu i angazhuar në Stamboll për përkthimin e tanishëm, është nga ndonjë pjesë e veriut të Shqipërisë, ndoshta nga bregdeti, ku italishtja është shumë e përzjerë me gjuhën vendase; në rast se është kështu, nuk ka përse të çuditemi, që ai nuk e kupton përkthimin ekzistues që është në shtyp. Rasti i kasapit që përmendej mund të jetë i njëjtë. Po të jetë kështu, ky përkthim nuk do të jetë i kuptueshëm në Shqipëri në tërësi, ndoshta do të jetë edhe më pak se përkthimi ynë ekzistues. Unë kam bindjen se meqë njeriu në Stamboll nuk e kupton versionin ekzistues, ai nuk është i aftë të krijojë një ide të saktë për shkallën në të cilën është i kuptueshëm. Arësyet e mia janë këto:

Përkthimi u bë në fillim nga një mjek i një krahine, dr. Meksi, vendas nga Shqipëria e mirëfilltë, me sa kam marrë vesh unë. Për këtë qëllim ai u angazhua nga dr. Pinkerton. U rishikua në Korfuz, në kohën që unë isha atje, prej një peshkopi të kishës greke, një njeri me disa njohuri dhe vendas nga Shqipëria e mirëfilltë. U shtyp në Korfuz dhe prej vendasve nga Shqipëria e mirëfilltë, kryesori prej tyre ka qenë shumë i vlefshëm për ne. Të gjithë këta shqiptarë e flisnin gjuhën e vet dhe e kuptonin përkthimin mirë. Dhjetorin e kaluar, kur unë vajta në Athinë për të rregulluar punën e një botimi të dytë, që tashti është atje në shtyp, rrugës ndalova në Syra dhe atje pata një takim me konsullin austriak, një njeri me njohuri të mëdha. Ai ka qëndruar për disa vjet në Janinë dhe aty i ka kushtuar vëmendje të veçantë gjuhës shqipe. Ai kishte dy libra në këtë gjuhë, të shtypura me shkronja latine, që unë nuk i dija se ekzistonin. Ai e kishte shqyrtuar versionin ekzistues dhe më tha se ishte bërë shumë mirë. Cilatdo qofshin meritat e përkthimit të ri, unë mendoj se kjo as nuk do ta bëjë të panevojshëm përkthimin ekzistues, as nuk ka të ngjarë fare të jetë njësoj me të nga pikëpamja e të kuptuarit dhe të dobisë, meqë ndoshta do të jetë i kapshëm për një pjesë shumë më të vogël të popullsisë së Shqipërisë. Versioni ekzistues është bërë nga shqiptarë të zotë, kuptohet prej tyre dhe prej një njeriu me aftësi të veçanta, i cili si i huaj e ka studjuar në vend; është në një gjuhë të kuptueshme dhe të folur nga pjesa më e ngritur e shqiptarëve, domethënë nga ata në Janinë e në pjesët e afërta në Greqinë e Veriut, si dhe nga shumë të tjerë në disa nga ishujt e Arkipelagut e në More, është i kapshëm në një shtrirje të cilën me sa duket nuk mund ta arrijë asnjë dialekt tjetër i shqipes.

Megjithatë versioni ekzistues mund të jetë i pakuptueshëm për përkthyesin në Stamboll dhe nëse përkthimi i tij do të dalë po aq i pakuptueshëm për shqiptarët, që përdorin një dialekt të ndryshëm prej të tijit, përsëri mund të jetë i dobishëm për popullsinë në pjesën e tij të vendit, në rast se nuk bën për Shqipërinë në përgjithësi.

* * *

Cili është ky njeri në Stamboll dhe cilat janë vetitë e tij, unë nuk kam mundësinë ta di. Thuhet që është besimtar — një kërkesë e rëndësishme, në rast se veç kësaj ka edhe një njohje kompetente të gjuhës e një gjykim të shëndoshë e të mprehtë, këto janë pikërisht çfarë kërkohet. Pa ditur gjë më tepër në veçanti, unë nuk do të nxi-tohem të jap mendim për besimin e nënkuptuar, që me sa duket i është dhënë, duke u mbështetur në pohimet e një njeriu të vetëm.

Dok. V.

Letër e I. Lowndes, sekretar i Shoqërisë biblike joniane.

Korfuz, 16 mars 1824

Sot ne patëm një mbledhje të Komitetit të Shoqërisë biblike joniane, ku u paraqit ungjilli i sh. Mateut në gjuhën shqipe, lidhur

me të cilin ju kam shkruar më parë. Në letrën e fundit ju njoftoja se arkimandriti nga Negroponti, i cili është vendas nga Shqipëria, e kishte mbaruar rishikimin dhe Komiteti ynë, pasi dëgjoji letrën tuaj dhe mori në shqyrtim punën, mori këtë vendim:

«U vendos që Ungjilli i sh. Mateut në gjuhën shqipe të shtypet, mbasi është rishikuar me kujdes nga arkimandriti Grigor i Negropontit, vendas nga Shqipëria. Të shtypet në shtylla paralele me greqishten e re, mbasi arkimandriti ka thënë se shqiptarët do të jenë në gjendje ta kuptojnë këtë më mirë se greqishten e vjetër. Të shtypet me shkronja të qarta e në letër të mirë, meqë shqiptarët nuk janë mësuar mirë me leximin dhe do t'i kuptojnë me vështirësi shkronjat e vogla».

Unë kam shprehur më parë mendimin tim se do të ishte më mirë që teksti shqip të shtypej në kolona paralele me tekstin në greqishten e vjetër, por nuk mund të qëndroj përpara arsyeve që jepen në vendimin e mësipërm në të mirë të greqishtes së re. Ndoshta shkronjat pak më të mëdha se sa ato me të cilat janë shtypur Raportet tona të fundit do të përshtateshin për shtypjen e kësaj vepre, dhe do të mjaftonin po të ishin fare pak më të mëdha. Kemi një sasi të mirë të shkronjave që sapo na kanë ardhur dhe unë do të kujdesem të përcaktoj përmasat e shkronjave që do të përshtaten më mirë, si për dobinë ashtu edhe për kursimin.

Shuma që mori Meksi për gjithë Dhjatën e re më del se ka qenë 6000 piastra; për Ungjillin që ne kemi në dorë ajo do të arrinte rreth 100 dollarë spanjollë.

Komiteti ynë pranoi t'i paguajë arkimadritit 60 dollarë për rishikimin dhe për ndreqjen e bocave. Do të ishim të gëzuar të dëgjonim mendimin e Shoqërisë biblike britanike dhe për vendet e huaja lidhur me këtë pikë.

Pak kohë më parë kam marrë një letër nga Z. Leeves, në të cilën më njofton se ka ndërmend me rastin më të parë të dërgojë në Korfuz gjithë Dhjatën shqip. Në këtë rast unë shpresoj se Komiteti i Shoqërisë biblike britanike dhe për vendet e huaja do ta angazhojë arkimandritin për rishikimin e saj. Ai i kushton një vëmendje të madhe kësaj dhe duket se është mjaft i përshtatshëm për këtë punë, pavarësisht se vetë është ekleziast. Punën e tij ua kam treguar të tjerëve vendas nga Shqipëria, të cilët e kanë miratuar shumë.

